

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Emine Kaçiku, kryetare, Nazmije Ibrahimimi dhe Shukri Sylejmani, anëtarë, në çështjen juridike të paditësit Xh. Sh., nga Gjilani, të cilin e përfaqëson M. M., avokat nga Gjilani, kundër të paditurës K. R. e U. ” H.”, nga Gjilani, të cilën e përfaqëson me autorizimit N. K., për anulimin e vendimit për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, përkitazi me revizionin e paditësit, paraqitur kundër aktgjyqimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.4691/2014, datë 30.9.2015 , në seancën e mbajtur më 16.3.2016, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Pranohet revizioni i paditësit dhe ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.4691/2014, datë 30.9.2015, ashtu që mbetet në fuqi aktgjykimi i Gjykatës Themelore Gjilan - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil , C.nr.201/2014, datë 20.10.2014.

A r s y e t i m i

Me pjesën I të dispozitivit të aktgjyqimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.4691/2014, datë 30.9.2015, është pranuar ankesa e të paditurës dhe është ndryshuar aktgjykimi C.nr.201/2014, datë 20.10.2014 i Gjykatës Themelore Gjilan - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil. Me pjesën II të dispozitivit është refuzuar si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit, me të cilën ka kërkuar anulimin e vendimit për ndërprerjen e kontratës së punës të D. R. “H.” nga Gjilani, nr. 347, datë 31.3.2014, dhe obligimin e së paditurës që ta kthejë në punë dhe në detyrat që i përgjigjen profesionit të tij, me të gjitha të drejtat, sipas bazës së punës; t’i paguajë të ardhurat mujore për periudhën 1.4.2014 deri më 1.6.2014 në shumën mujore prej 620 €, prej datës 1.6.2014 deri më 1.9.2014 në shumën mujore prej 670 €, ndërsa prej shtatorit e deri në përfundim të pagesës shumën prej 720 €, me kamatën vjetore prej 8% si dhe t’ia paguajë shpenzimet e procedurës në shumën prej 370 €. Është vendosur që secila palë në procedurë t’i heqë shpenzimet e veta të procedurës.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë paditësi me kohë ka paraqitur revizion, për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, parashikuar nga neni 182 par.1 e 2 pika (n), lidhur me nenin 142 par.2 , nenin 201 të LPK-ës dhe zbatimin të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë të ndryshohet, ashtu që aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë të vërtetohet ose aktgjykimi i kundërshtuar të priset dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së dytë për rigjykim.

E paditura ka paraqitur përgjigje ndaj revizionit, me propozimin që ky të refuzohet si i pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe aktgjykimit të goditur, sipas dispozitës së nenit 215 të LPK, konstatoi:

Revizioni është i bazuar.

Nga shkresat e lëndës del se paditësi ka qenë në marrëdhënie pune tek e paditura, në pozitën dhe detyrat e punës - zyrtar i lartë financiar, sipas kontratës së punës nr. ... , duke filluar nga data ... Me vendimin e Bordit të drejtorëve të së paditurës nr. ... datë ..., paditësit i është ndërprerë kontrata e punës nga data 1.4.2014, konform nenit 21.1 të Ligjit nr. 04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 03/L-087 për N. P., Në aktvendimin e përmendur ka munguar këshilla juridike për të drejtën e ankesës, kështu që paditësi, më 14.4.2014, i është drejtuar gjykatës për realizimin e të drejtave të tij nga marrëdhënia e punës.

Në bazë të kësaj gjendjeje faktike, gjykata e shkallës së parë ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar dhe ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit.

Gjykata e shkallës së dytë, duke vepruar në procedurën ankimore, ka vlerësuar se qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i papranueshëm, sepse e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të gabuar, ngase neni 21.1 i Ligjit për Ndërmarrjet Publike i jep autorizim Këshillit Drejtues që me shumicë votash t'ia ndërpresë punëmarrësit marrëdhënien e

punës pa ndonjë arsye dhe pa përmendur shkakun e ndërprerjes së kontratës, pastaj ka vendosur si në dispozitivin e aktgjykimit të saj.

Nisur nga kjo gjendja e çështjes, Gjykata Supreme e Kosovës vlerësoi se gjykatat e instancave më të ulëta kanë vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike, por mbi këtë gjendje faktike gjykata e shkallës së dytë e ka zbatuar në mënyrë të gabuar të drejtën materiale kur ka vlerësuar se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar, për çka u desh që aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë të ndryshohet, kurse aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë të lihet në fuqi.

Gjykata Supreme e Kosovës shton se me nenin 15 të kontratës së punës nr.588, datë 1.7.2013, janë parashikuar shkaqet për të cilat të punësuarit i ndërpritet marrëdhënia e punës nga punëdhënësi (1. ndërprerja për arsye ekonomike, teknike ose organizative; 2. i punësuar nuk është i aftë t'i kryejë detyrat e punës; 3. në rastet e rënda të sjelljes së keqe të të punësuarit ; 4. për shkak të përmbushjes së pakënaqshme të detyrave të punës dhe 5. për raste të tjera të përcaktuara me Ligjin e Punës), ndërsa në vendimin për ndërprerjen e kontratës së punës të Bordit të drejtorëve nuk vihet në dukje asnjëri nga shkaqet e përmendura; po ashtu, nga vendimi i kundërshtuar i të paditurës nuk vërtetohet se për cilat shkelje të detyrave të punës është ndërprerë kontrata.

Sipas nenit 18 të kontratës së punës, punëdhënësi dhe i punësuar i pranojnë të gjitha të drejtat dhe detyrimet e caktuara me Ligjin për Ndërmarrjet Publike, Ligjin e Punës, me Kontratën kolektive dhe me këtë kontratë, ndërsa në nenin 21 të kësaj kontrate është përcaktuar se në asnjë rast dispozitat e saj nuk mund të jenë më pak të favorshme për të punësuarin dhe punëdhënësin, se dispozitat e Ligjit të Punës dhe Ligjit për Ndërmarrjet Publike, për sa u përket të drejtave dhe kushteve nga marrëdhënia e punës, andaj Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se me kontratën e punës është parashikuar edhe zbatimi i Ligjit të Punës nr. 03/L-2012, i cili në kreun VIII parashikon ndërprerjen e marrëdhënies së punës. Në nenin 70 të Ligjit të Punës parashikohen kushtet ligjore kur punëdhënësi mund t'ia ndërpresë kontratën e punës të punësuarit, ndërsa në neni 72 parashikon procedurën para ndërprerjes së kontratës, duke

përcaktuar me pikën 1 të këtij neni se vendimi për ndërprerjen e kontratës së punës duhet të bëhet me shkrim dhe të përfshijë arsyetimin për ndërprerjen.

Gjykata Supreme e Kosovës gjen se gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar drejt se në rastin konkret performanca e paditësit për punën e tij, si zyrtar i lartë financiar, ka qenë e shkëlqyer, kurse ndërprerja e kontratës së punës pa asnjë shkak është vendim joligjor.

Vlerësimi juridik i gjykatës së shkallës së dytë se neni 21.1 i Ligjit për Ndërmarrjet Publike i jep autorizim Bordit të Drejtorëve që me shumicë votash ta ndërpresë marrëdhënien e punës, se nuk është obliguar të japë kurrfarë arsytimi dhe nuk është e obliguar ta vërë në dukje në vendimin e vet shkakun e ndërprerjes së kontratës së punës, për Gjykatën Supreme të Kosovës është i pabazuar, i papranueshëm e i kundërligjshëm dhe bie ndesh me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe me nenin 1 të Protokollit 1 të Konventës, i cili përfshin gjykimin e drejtë dhe barazinë e armëve të palëve pjesëmarrëse në procedurë. Ky parim shprehet në faktin që secili që është palë në procedurë duhet të ketë mundësinë e arsyeshme për të paraqitur rastin e vet në kushtet që nuk e vënë atë në pozitë substancialisht të pafavorshme përballë kundërshtarit të vet.

Në vendimin nr. 347, datë 31.3.2014, nuk janë paraqitur arsyet e ndërprerjes së marrëdhënies së punës dhe nuk është dhënë e drejta e ankesës, si mjet juridik, prandaj Gjykata Supreme e Kosovës gjen se gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar drejt se vendimi i përmendur është i kundërligjshëm, sepse në rastin konkret është cenuar jo vetëm parimi i administrimit të drejtësisë, por edhe barazia e armëve që konsiston në pamundësimin e shfrytëzimit të ankesës në mënyrë efektive dhe paditësi në këtë mënyrë është vënë në pozitë substancialisht të pafavorshme përballë të paditurës. Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se Bordi i drejtorëve i të paditurës ka vepruar në kundërshtim edhe me nenin 31 par. 1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, e cila garanton mbrojtje të barabartë të të drejtave në procedurë para gjykatave, organit tjetër shtetëror dhe bartësve të kompetencave publike, ndërsa neni 32 i Kushtetutës garanton se secili person ka të drejtë të përdorë në mënyrën e përcaktuar me ligj mjete juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative, të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e tij. Me nenin 54 të Kushtetutës, parashikohet, po ashtu, se çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose

mohimit të ndonjë të drejte të parashikuar në Kushtetutë ose ligj si dhe të drejtave të tjera, me mjete efektive ligjore, nëse konstatohet se një drejtë e tillë është shkelur.

Për këto fakte, Gjykata Supreme e Kosovës i vlerësoi si të bazuara thëniet në revizion se gjykata e shkallës së dytë ka zbatuar në mënyrë të gabuar të drejtën materiale kur ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit.

Në bazë të asaj që u tha e me zbatimin e dispozitës nga neni 224 par.1 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË

Rev.nr.10/2016 datë 16.3.2016

Kryetare e kolegjit,
Emine Kaçiku